



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



ZYRA PËR REGJISTRIMIN, CERTIFIKIMIN DHE KONTROLLIN FINANCIAR TË SUBJEKTEVE POLITIKE (Zyra) NË KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE (KQZ) sipas autorizimeve të dhëna me paragrafin 1 të nenit 21 dhe në përputhje me nënparagrafin 8, paragrafi 6 i nenit 21 i Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike (LFSP), me datën 10.07.2024, merr këtë:

VENDIM

Për shqiptimin e gjobës për subjektin politik të regjistruar PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKANLIVE TË KOSOVËS

- I. Subjektit politik PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKANLIVE TË KOSOVËS, i shqiptohet gjoba në vlerë katër mijë (4,000) euro për shkeljen sipas nënparagrafit 8, paragrafi 6 i nenit 21 të LFSP.
- II. Subjekti politik PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKANLIVE TË KOSOVËS, obligohet që brenda tridhjetë (30) ditësh pas pranimit të këtij vendimi, të paguaj shumën e gjobës së shqiptuar sipas pikës I të këtij vendimi dhe të dorëzojë në Zyrës një kopje të fletëpagesës së gjobës së paguar.
- III. Me kalimin e afatit të përcaktuar në pikën II të këtij vendimi, gjobat ekzekutohen në mënyrë të detyrueshme nga Përmbartuesi Privat.
- IV. Vendimet e Zyrës për shqiptimin e gjobave hyjnë në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe janë përfundimtare dhe të ekzekutueshme.

Arsyetim

Subjekti politik PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKANLIVE TË KOSOVËS, është subjekt politik i regjistruar në përputhje me legjislacionin në fuqi, nga data 19.07.2002.

Pas dorëzimit të raportit vjetor financiar nga partia politike, Zyra ka vërejtur se subjekti politik ka pranuar kontribute në kundërshtim me nenin 4 të LFSP.

Në përputhje me paragrafin 5 të nenit 4 të LFSP që thekson se në rast se një subjekt politik ka pranuar mjete financiare në kundërshtim me dispozitat e LFSP, subjekti politik obligohet që brenda dy (2) javës nga data e pranimit të këtyre mjeteve, të kthejë ato përmes llogarisë bankare në burmimin e pranimit dhe brenda të njëjtit afat të njoftojë KQZ. Zyra me datën 01.04.2024 ka dërguar kërkesë te subjekti politik PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKANLIVE TË KOSOVËS,

që mban numrin e protokollit 212/01.04.2024, përmes së cilës, ka kërkuar nga subjekti politik që mjetet financiare të pranuar përmes arkës (para të gatshme) nga personi fizik në vlerën totale 3,000 euro, t'i kthejë përmes transaksionit bankar.

Subjekti politik nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në kthimin e këtyre mjeteve, siç është kërkuar përmes kërkesës, me ç'rast gjetja është konstatuar edhe nga auditori ligjor, e cila është prezantuar në raportin përfundimtar të auditimit.

Subjekti politik PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKANLIVE TË KOSOVËS, obligohet që pagesën ta kryejë brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimin të vendimit për shqiptimin e gjobës përmes komunikimit zyrtar elektronik. Pagesa e gjobës duhet të dëshmohet përmes dorëzimit të kopjes së fletëpagesës në Zyrë. Në rast të dështimit të pagesës së gjobës brenda afatit të dhënë si në pikën II të këtij vendimi, gjoba e shqiptuar ndaj subjektit politik do të ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Përmbartuesi Privat.

Nga sa u tha më lartë, Zyra vendosi për shqiptimin e gjobës në vlerë prej katër mijë (4,000) euro, sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Prishtinë, 10.07.2024

Drejtori i Zyrës



Besnik Buzhala

Vendimi i dërgohet:

- Kryetarit të subjektit politik PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKANLIVE TË KOSOVËS
- Përfaqësuesit të autorizuar financiar të subjektit politik PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKANLIVE TË KOSOVËS

Këshilla juridike: Subjekti politik mund të inicojë padi kundër vendimit të Zyrës për shqiptimin e gjobave, pranë gjykatës kompetente të shkallës së parë, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, pas njoftimit për vendimin. Inicimi i padisë nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.